



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

VENDIM

Nr. 67, datë 28.12.2020

**PËR MIRATIMIN E RAPORTIT PËR RENDITJEN E KANDIDATËVE TË LEJUAR
PËR PLOTËSIMIN E VENDIT VAKANT TË KRIJUAR NË GJYKATËN
KUSHTETUESE, VAKANCË E PARAKOHSHME, E SHPALLUR NGA
PRESIDENTI I REPUBLIKËS NË DATËN 22.11.2019**

Në mbështetje të pikës 1 të nenit 125 dhe të pikës 1 të nenit 149/d të Kushtetutës, të pikës 3 të nenit 7/b të ligjit nr. 8577/2000, të pikës 5 të nenit 229 dhe nenit 240 të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", si edhe të pikave 71 e 72 të vendimit nr. 5 datë 02.04.2019 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi "Për kriteret dhe procedurën e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, pasi përfundoi vlerësimin dhe pikëzimin e kandidatit të lejuar për këtë vend vakant, si dhe miratoi listën përfundimare të renditjes së kandidatëve,

VENDOSI:

1. Miratimin e raportit për renditjen e kandidatëve të lejuar për plotësimin e vendit vakant të krijuar në Gjykatën Kushtetuese, vakancë e parakohshme, e shpallur nga shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 22.11.2019.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, në pjesën e përcaktuar për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi.

ZËVENDËSKRYETARE

Vitore TUSHA

ANËTARE

Miranda ANDONI

ANËTARE

Arta MARKU

ANËTARE

Fiona PAPAJORGJI

ANËTARE

Fatjona MEMÇAJ

ANËTARE

Saida DOLLANI

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2020

Adresa Postare : GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.

Adresa Elektronike : info@ked.gov.al Numra telefonikë : +355 4 2257302